



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PROJEKTEVE TË HUAJA INTEGRIMIT EUROPIAN DHE DIASPORËS

Nr. 14428 Prot

Vlorë, më: 18.09 2024

PROCESVERBAL KONSULTIM PUBLIK
NJËSIA ADMINISTRATIVE SHUSHICE

Datë 10.09.2024 ora: 17:00

Tema: Konsultimi i Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 dhe planifikimi për projektbuxhetin e vitit 2025 për Bashkinë Vlorë

Baza Ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Per të drejtën e informimit” , ligjit nr.146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funkcionimit të Bashkisë; si dhe Kalendarit të Konsultimit Publik nr.13107 datë 21.08.2024.

Marrin pjesë:

Nënkryetari i Bashkisë, z. Klevis Kaso; Administratori i Njesisë Administrative, z. Birçe Aliraj; Anëtarë të Këshillit Bashkiak; Kryetarë të fshatrave dhe banorë të njesisë administrative; Përfaqësues nga administrata e bashkisë

(Në takim morrën pjesë më shumë se 20 persona, listëprezenca bashkangjitur)

Takimin e hapi Z.Birçe Aliraj – Siç jeni njoftuar sot bëjmë dëgjuesën publike, për buxhetin e vitit 2025. Investimet e parashikuara;

-Rikonstruksioni i rrugës në fshatin Drithas.

-Në fshatin Risili, rikonstruksioni i rrugës së varrezave .

-Në fshatin Çeprat, ndriçimi.

-Në fshatin Bunavi , rikonstruksioni i rrugës së brendshme, nga Bestrova.

-Rikonstruksion i rrugës në fshatin Grabian dhe ndriçim, 900m.

-Në fshatin Llakatund, rikonstruksion i rrugëve të brendëshme, si dhe ndriçim.

-Në fshatin Drithas, rikonstruksion i rrugës plus ndriçim.

-Në fshatin Mekat, rikonstruksioni i rrugës deri tek çezma.

Të gjitha kërkesat që u bënë për vitin 2024, thuajse janë 90% të realizuara. Probleme me pastrimin nuk kemi patur, me ujën e pijshëm jo. Falënderoj drejtorin e shërbimeve.

Z.Klevis Kaso – Faleminderit të gjithëve për kohën që gjetët për këtë dëgjese. Jemi këtu për të diskutuar për problemet tuaja, pasi jemi duke hartuar PBA 2025 -2027 si dhe Buxhetin për vitin 2025. Por jo vetëm kaq. Deri në miratimin në Këshillin e Bashkisë, jeni të lutur të vini me propozime konkrete.

Z.Kozma Mali – Bashkia Vlorë , në investimet e parashikuara për këtë njësi;

-Rikonstruksioni i rrugës së fshatit Drithas, vetëm për tu lidhur kontrata.

-Rikonstruksioni i rrugës së varrezave në fshatin Risili, me një vlerë 9 milion..

-Rikonstruksioni i rrugës në fshatin Grabian.

-Rikonstruksioni i rrugës së fshatit Bunavi .

Z.Birçe Aliraj – Në njësinë tonë, është ndjerë dora e bashkisë. Gjej rastin të falënderoj Kryetarin e Bashkisë që, për premtimet e bëra në vitin 2023, i bëri realitet. Po bashkëpunohet dhe me FSHZH, për projekte të tjera.

Z.Spiro Dëma/Kryetar i fshatit Bunavi – Kemi problem dhe duam të bëhet rruga brenda në fshat. Të bëhet diçka.

Kryetari i fshatit Risili – Më bëhet qejfi që, zoti Birçe thotë që, ka marrë fund rruga e varrezave të fshatit Risili. Është punuar, por kemi dhe disa nevoja si, llampa për ndriçim. Problem tjetër, pastrimi i kanalit, se me fillimin e shirave fillojnë përmythen fushat.

Z.Birçe Aliraj – Projekti është gati, por nuk është pjesë e bashkisë.

Kryetari i fshatit Risili – Tek rrotonda e varrezave të qëndrojnë policia. Çfarë masash do të merren për ndalimin e qarkullimit të mjeteve të rënda?

Kryetare e fshatit Llakatund - Falënderoj Kryetarin e Bashkisë, për premtimin e mbajtur për rrugën e Grabianit. Por, kemi nevojë për ndriçim, me buxhet të vogël. Ujësjiellësi i fshatit nuk varet nga bashkia. Duhet të shikohet seriozisht problemi i ujit.

Z.Birçe Aliraj – Do ta kërkojmë.

Kryetari i fshatit Mekat – Drejtori i shërbimeve na është përgjigjur, për problemet që kemi patur. Rikonstruksioni i rrugës së fshatit...

Z.Klevis Kaso – Është bërë projekti. E kemi gati, do diskutohet me FSHZH.

Kryetari i fshatit Grabian – Ju falënderojmë për fillimin e rikonstruksionit të rrugës së fshatit.

Z.Klevis Kaso – Ju faleminderit për pjesëmarrjen.

Koordinatore për njoftimin dhe konsultimin publik

Albana Naçi

